



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më .12.2025

MBLEDHJA Nr. 53,
Datë 29.12.2025, ora 12:00
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 29.12.2025, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 53 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes të energjisë elektrike.
2. Mbi miratimin e “Kodit të rrjetit mbi emergjencën dhe rivendosjen”.
3. Mbi miratimin e një “Udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.
4. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “VOLTON” sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë OSSH sh.a., lidhur me pikën e matjes “TONA ALB/6390”.
5. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI